



Komuna Vushtri

KRM.Uniteti-Vushtri

Bazuar në nenin 9 të paragrafit 4 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, nenin 17, pika (f) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, nenin 15, paragrafi 1 nënparagrafi 1.8 dhe paragrafi 3.të Ligjit Nr. 04/L-060 për Mbeturina, nenin 79, pika (o) të Statutit të Komunës, Planin pesëvjeçar të menaxhimit të mbeturinave 2016-2020 i miratuar me vendimin e KK-së 01nr. 190/15 i datës 29.09.2015, Rregulloren për menaxhim të mbeturinave, më datë 29.06.2018, arritën këtë:

### MARRËVESHJE

për

Shërbimet primare të menaxhimit të mbeturinave në territorin e Komunës së Vushtrrisë

NË MES TË KOMUNËS SË VUSHTRISË  
më tutje "Komuna"

dhe

KOMPANISË PUBLIKE REGJIONALE "UNITETI"  
më tutje "Uniteti"

#### Palët kontraktuese:

Komuna e Vushtrrisë, të cilën e përfaqëson Xhafer Tahiri, Kryetar i Komunës së Vushtrrisë (në tekstin e mëtejme komuna).

Kompania rajonale "Uniteti", Vushtri, të cilën e përfaqëson Tahir Krasniqi, drejtor (në tekstin e mëtejme "Uniteti").

(tutje të referuar si "Palët kontraktuese")

Kjo marrëveshje për shërbime (Kontratë në shtëpi-KSH) i përmban elementet standarde dhe të detyrueshme për t'u konsideruar e vlefshme.

## **Neni 1 Qëllimi**

1. Qëllimi i marrëveshjes:

- 1.1. Përcaktimi i shërbimeve që "Uniteti" ia ofron komunës dhe standardet e kërkuara për mënyrën e ofrimit, operimit dhe menaxhimit të këtyre shërbimeve.
- 1.2. "Uniteti" dhe komuna t'i kryejnë obligimet të specifikuar sipas Rregullore Komunale për Menaxhimin e Mbeturinave nr.189/15 dt.29.09.2015, Planit Komunal për Menaxhimin e Mbeturinave nr.190/15 dt.29.09.2015.
- 1.3. Përshkrimi i kërkesave për menaxhimin cilësor të shërbimeve, duke përfshirë specifikacionet e shërbimit, monitorimin e performancës dhe raportimin.

## **Neni 2 Fushëveprimi i shërbimit, kohëzgjatja dhe kushtet themelore**

1. Komuna kontraktin "Unitetin" për t'i kryer të gjitha shërbimet në përputhje me këtë kontratë.
2. Kjo KSH vlen për periudhën gjashtëmuajore, nga data 01 korrik 2018 deri më datë 31 dhjetor 2018 me mundësi vazhdimi.
3. Gjatë kohëzgjatjes të kësaj kontrate, "Uniteti" i mbledh, largon dhe transporton mbeturinat komunale siç janë përkufizuar në këtë kontratë dhe sipas nenit 34 të Ligjit për Mbeturinat, dhe Rregullore Komunale për Menaxhimin e Mbeturinave 01.nr.189/15 dt.29.09.2015.
4. Gjatë kohëzgjatjes të kësaj kontrate, "Uniteti" i mbledh, largon dhe transporton mbeturinat komunale që prodhohen brenda zonës së kufijve komunalë siç është përkufizuar në shtojcën B.
5. "Uniteti" e siguron tërë personelin dhe pajisjet e nevojshme (siç janë përkufizuar këtu) për të ofruar një shërbim të kënaqshëm, në mënyrë që të jetë në përputhje me specifikacionet e shërbimit që janë përfshirë në shtojcën A të kësaj KSH-je.
6. "Uniteti" i mbledh dhe transporton mbeturinat komunale nga të gjitha amvisëritë, subjektet afariste dhe institucionet publike që gjenden në zonën e shërbyer në vendin/vendet i/e caktuara (siç tregohet nga komuna dhe sipas radhitjes në shtojcën B), brenda orarit të punës në objektin përkatës.

## **Neni 3 Përkufizimet**

1. Nocionet në kuptim të kësaj marrëveshjeje kanë këtë domethënie:

- 1.1. PIO – Plani i Itinerarit Operativ
- 1.2. KSH-Kontrata në Shtëpi
- 1.3. PAMKOS- Shoqata e të gjitha Kompanive Regjionale të Mbeturinave në Republikën e Kosovës.

#### **Neni 4** **Shërbimet që do të ofrohen**

Shërbimet që do të ofrohen sipas kësaj kontrate (sipas standardeve të detajuara të shërbimit që janë paraparë në shtojcën A), të përmbledhen si shërbim primar për mbledhje, transportim dhe deponim të mbeturinave.

#### **Neni 5** **Objektivat kryesore të këtyre shërbimeve**

1. Të ofrojë shërbime të menaxhimit të mbeturinave në mënyrë efikase, e të bazuar në efikasitet të kostos në përputhshmëri me standardet mjedisore dhe operative.
2. Të mbrohen banorët dhe mjedisi nga ndotja dhe rreziqet e tjera ndaj shëndetit.

#### **Neni 6** **Fuqia madhore**

1. Nga "Uniteti" nuk do të kërkohet që t'i kryejë shërbimet që janë saktësuar në neni 4 si më lart nëse pengohet për ta bërë këtë nga ndonjë fuqi madhore.
2. Me termin "Fuqi madhore" brenda kësaj kontrate nënkuptojmë një ngjarje që është përtej kontrollit të arsyeshëm të një pale, e cila shkakton pamundësinë e përmbushjes së detyrimeve të palës në këtë kontratë ose është jopraktike dhe konsiderohet e pamundur për shkak të rrethanave të krijuara. Ajo përfshin, luftën, protestat, mosbindjen civile, tërmetin, zjarrin, shpërthimet, stuhitë, përmytjet, etj.
3. Fuqia madhore nuk përfshin një ngjarje e cila shkaktohet nga neglizhenca apo veprimi me qëllim i njërës palë apo agjentëve ose punëmarrësve të saj; asnjë ngjarje të cilën një palë e kujdesshme në mënyrë të arsyeshme duhet ta kishte marrë parasysh në kohën e nënshkrimit të kësaj kontrate dhe që mund të ishte shmangur ose tejkaluar me përmbushjen e detyrimeve në këtë kontratë.
4. Fuqia madhore nuk përfshin pamjaftueshmërinë e fondeve për të operuar ose moskryerjen e një pagese që duhet kryer sipas kontratës.

#### **Neni 7** **Standardet specifike të shërbimit**

Shërbimet e menaxhimit të mbeturinave ofrohen në përputhje me specifikacionet e hollësishme të shërbimit që janë paraparë në shtojcën A dhe që janë përmbledhur.

#### **Neni 8** **Mbledhja, transportimi dhe deponimi i mbeturinave**

1. "Uniteti" siguron që të ofrohet numër i mjaftueshëm i kontejnerëve për mbledhjen e mbeturinave nga subjektet e shërbyera në mënyrë që vëllimi dhe specifikacionet e tyre të mjaftojnë për ta vendosur në to sasinë e mbeturinave komunale të prodhuara. Numri dhe lloji i kontejnerëve duhet të llogaritet duke e përdorur një shkallë mesatare të prodhimit të mbeturinave dhe duke u bazuar në përvojën e mëparshme.

2. "Uniteti" ofron shërbim të mbledhjes së mbeturinave të rregullt dhe të besueshëm, duke u siguruar që të janë vendosur në kontejnerë të gjitha mbeturinat komunale që (apo që janë derdhur përreth tyre) të mbliidhen dhe transportohen në vendet e caktuara.

3. Ky shërbim do të ofrohet duke u bazuar në Planin e Itinerarit dhe Operativ (PIO-në) për çdo zonë të shërbimit. Në ditët pas festave zyrtare mund të kërkohen shërbime shtesë.

4. Me qëllim të efikasitetit të punës, "Uniteti" e përgatit dhe dorëzon një PIO dhe në të përfshin:

4.1. Sistemin e itinerarit, duke u bazuar në lokacionet e kontejnerëve (posaçërisht të kontejnerëve të komunitetit), siç është përcaktuar nga komuna, në secilin vendbanim brenda zonës së shërbimit të mbledhjes së mbeturinave, "Uniteti" duhet ta krijojë një sistem të itinerarit të cilin do ta ndjekin automjetet për mbledhjen e mbeturinave dhe t'ia dorëzojë atë komunës për aprovim.

4.2. Mbledhja e mbeturinave dhe orari i shërbimeve duhet të bazohen në llogaritjet, specifikacionet e secilit vendbanim dhe përvojën e mëparshme të "Unitetit". Llogaritjet për secilin vendbanim duhet të bazohen në numrin e banorëve, llojet e mbeturinave të prodhuara dhe shkallët e prodhimit të mbeturinave.

4.3. Intervalet e rishikimit: PIO-ja do të rishikohet duke u bazuar në një mekanizëm drejtues në intervale periodike prej 3 muajsh apo kur të kërkohet nga komuna.

5. Në zonat ku ka qasje të kufizuar të automjeteve, "Uniteti" mund të sigurojë kontejnerë të komunitetit në periferi të vendbanimit apo t'i mbledhë dhe largojë mbeturinat, duke përdorur automjete të vogla me specifikacione të përshtatshme teknike. "Uniteti" i ofron shërbimet e mbledhjes dhe transportimit të mbeturinave me anë të automjeteve/pajisjeve teknologjike në dispozicion, të përshtatshme për lëvizje në këtë zonë dhe të pajisura me një pajisje funksionale për ngritje mekanike.

## **Neni 9**

### **Mbulimi me shërbime**

1. "Uniteti" është përgjegjëse sipas kësaj kontrate që të ofrojë shërbime të mbledhjes dhe transportimit të mbeturinave nga të gjitha vendbanimet brenda hapësirës së shërbimit, siç është përkufizuar në këtë kontratë. "Uniteti" është përgjegjës për pastërti në hapësirën e definuar, duke përfshirë heqjen e të gjitha mbeturinave komunale të parrezikshme.

2. Për secilin vendbanim, "Uniteti" do të ofrojë shërbim të duhur të mbledhjes së mbeturinave ose duke u bazuar në kushtet lokale ose siç është përkufizuar në PIO, duke përdorur kontejnerë të përbashkët apo përmes shërbimit derë më derë.

3. Shërbimet që do të ofrohen varen nga lloji i institucionit, lloji i mbeturinës së prodhuar, sasi të mbeturinave të prodhuara dhe vendndodhja në raport me subjektet tjera të shërbyera.

## **Neni 10**

### **Resurset dhe shkathtësitë**

1. Shërbimet e menaxhimit të mbeturinave do të ofrohen nga një ekip i trajnuar në mënyrë adekuate dhe profesionale që i posedon shkathtësitë relevante për ta ndërmarrë shërbimin.
2. Në të gjitha objektet dhe vendet e caktuara për menaxhimin e mbeturinave punësohen anëtarë të trajnuar të personelit, të specializuar në detyrat përkatëse të tyre.
3. Ekipi i menaxhimit "Uniteti" ndërlidhet dhe bashkërendohet me komunën dhe është i hapur për inspektim nga përfaqësuesit e komunës (zyrtari i mbeturinave) në çdo kohë.
4. "Uniteti" siguron numër adekuat të punonjësve me shkathtësinë dhe trajnimin e duhur për t'i kryer shërbimet sipas kësaj kontrate. Secili punonjës mban veshur rroba që janë sa më të rregullta dhe më të pastra që i lejojnë rrethanat dhe mban rroba mbrojtëse personale, siç janë jelekët me dukshmëri të lartë, dorëzat e qëndrueshme edhe çizmet e helmetat e sigurisë sipas nevojës.
5. Para datës së fillimit të kësaj kontrate, "Uniteti" ua ofron përfaqësuesve të komunës një listë të detajuar në të cilën përshkruhen pajisjet (përkatësisht automjetet dhe kamionët për ngjeshje) dhe burimet njerëzore që do të përdoren për t'i kryer shërbimet. Lista përfshin prodhuesin e automjetit, madhësinë e motorit, numrin e regjistrimit/identifikimit dhe datën e prodhimit të çdo pajisjeje që do të përdoret. Çdo pajisje përfshihet në PIO/Planin Operativ.

## **Neni 11**

### **Monitorimi dhe raportimi**

1. "Uniteti" i harton dhe dorëzon raportet e kërkuara sipas manualit të PAMKOS-it për menaxhimin e cilësisë. Shabllonet për raportim që duhet të përdoren për këtë qëllim do t'i sigurojë PAMKOS-i.
2. Elementet e detyrueshme që duhet të raportohen përfshijnë sasinë e mbeturinave të mbledhura, automjetet e dërguara, numrin e udhëtimeve, distancën e përshkuar, numrin e punëtorëve, orët e punës, karburantin e shpenzuar.
3. Këto raporte verifikohen dhe monitorohen nga komuna, përmes zyrtarit të menaxhimit të mbeturinave sipas kushteve të kësaj kontrate. Monitorimi nga komuna përfshin edhe monitorimin e itincrarit përmes GPS-ve, si dhe në terren përmes vizitave.

## **Neni 12**

### **Përgjegjësitë e komunës**

1. T'i caktojë, në bashkërendim me "Unitetin", lokacionet për vendosjen e kontejnerëve (sipas llojit) në vendbanime të ndryshme dhe në afërsi të arsyeshme me subjektet e shërbyera.
2. Komuna do t'i kontrollojë rregullisht, përmes zyrtarit për menaxhim të mbeturinave dhe të përpilojë raporte për mbikëqyrjen, gjendjen e konstatuar, masat dhe veprimet që janë marrë, përkatësisht urdhëruar.
3. Një kopje e raportit duhet t'i dorëzohet "Unitetit". Inspektori mbanë shënime për

inspektimet që bëhen sipas procedurës që është përcaktuar në dispozitat e Ligjit Nr.03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit, si dhe për procedurat e ndëshkimit bazuar në Udhëzimin Administrativ MMPH-Nr 14/2015 për ndëshkimet me gjoba.

4.Komuna do të caktojë lokacionin për deponimin e mbetjeve ndërtimore.

5.Komuna mund ta testojë rregullisht kënaqësinë e konsumatorëve me shërbimet e ofruara, duke përcaktuar procedura adekuate dhe duke e nxjerrë një raport të shkurtër për nivelin e kënaqjes së konsumatorëve.

### **Neni 13**

#### **Përgjegjësitë e “Unitetit”**

1.T'i kryejë shërbimet në përputhje me këtë kontratë me tërë shkathtësinë dhe kujdesin e duhur.

2.Të mbledhë, transportojë, trajtojë dhe deponojë të gjitha mbeturinat nga amvisëritë, mbeturinat të gjeneruara nga bizneset që veprojnë brenda qytetit, mbeturinat e vëllimshme brenda qytetit, mbeturinat ndërtimore brenda qytetit dhe mbeturinat animale.

3.Të sigurohet që të gjitha mbeturinat e mbledhura të dërgohen në vendet e caktuara në Deponinë sanitare regjionale “Gërmovë” apo ndonjë deponi tjetër të caktuar nga komuna.

4.Të marrë veprime për t'u siguruar që asnjë mbeturinë e grumbulluar të mos depozitohet ilegalisht apo pa vend, duke e ndotur mjedisin dhe duke e rrezikuar shëndetin e popullatës.

5.Uniteti do të sigurohet që të gjitha faturat e pranuar nga Komuna e Vushtrisë përmes stafit të tij t'i dërgojë tek konsumatorët e shërbimit, më së largu deri në datën 10 të muajit pasues.

6.Të përgatitet dhe dorëzohet një PIO për aktivitetin e shërbimit, në të cilin trëgohen operacionet rutinore për çdo vendbanim të shërbyer.

7.Të jetë përgjegjës për propozimin e orarit dhe të bëjë raportimin për progresin, parashikimin dhe kontrollimin e pavarur për ta arritur kryerjen e shpejtë dhe efikase të shërbimeve.

8.Të jetë përgjegjës për pagesën e të gjitha çështjeve financiare, duke përfshirë pagesat e pagave për staf, pagesën për deponimin e mbeturinave në Deponinë sanitare regjionale “Gërmovë” apo ndonjë deponi tjetër të caktuar nga komuna, të ardhurave dhe tatimet tjera, kontributet e sigurimit kombëtar ose taksat e çfarëdo lloji që ndërlidhen me punësimin e ndonjë personi apo që burojnë nga ai punësim ose që ndërlidhen me funksionimin e kompanisë.

9.Të krijojë dhe mirëmbajë një linjë telefonike pa pagesë dhe publikisht të dukshme brenda “Unitetit”, me një numër të telefonit dhe/ose adresë të postës elektronike në të cilën mund të kontaktohet në çdo kohë të ditës dhe të jetë në gjendje t'i pranojë ankesat dhe në sekretariatit e operativës/selisë së “Unitetit”.

10.Ankesat do të evidentohen dhe përgjigjet në to do të jepen në mënyrë të shpejtë, të njerëzishme dhe efikase, si dhe duhet të mbahen dhe të vihen në dispozicion për inspektim evidenca me shkrim për të gjitha ankesat që janë pranuar dhe veprimet që janë marrë në lidhje me ankesat e tilla.

11. Të sigurojë mirëmbajtjen e rregullt dhe preventive të të gjitha automjeteve dhe pajisjeve të nevojshme për ofrimin e shërbimeve të saktësuara, në mënyrë që të ngritet në maksimum produktiviteti dhe jetëgjatësia e pajisjeve për përdorim.

12. Të jetë përgjegjës për sigurinë e të gjitha pajisjeve që përdoren në lidhje me ofrimin e shërbimeve të përshkruara në këtë kontratë.

13. Është përgjegjës për të siguruar kushtet e nevojshme për mbrojtje në punë, me të cilat sigurohet mbrojtja e jetës dhe e shëndetit të të punësuarve në pajtim me ligjin.

#### **Neni 14** **Faturimi dhe pagesa**

1. Komuna do të lëshojë një komunikatë për media ku informon qytetarët që nga 1 korriku 2018, shërbimi i grumbullimit të mbeturinave do të faturohet nga Komuna e Vushtrrisë.

2. Faturimi do të bëhet në baza tremujore dhe fatura dorëzohet nga "Uniteti" tek gjeneruesit e mbeturinave më së largu në afatin kohor prej 10 ditësh, pas pranimit të faturave nga komuna.

3. Pagesën e faturave nga gjeneruesit e mbeturinave e arkëton Komuna e Vushtrrisë.

4. Komuna e Vushtrrisë paguan "Unitetin" për shërbimin e kryer, në bazë të faturës së pranuar.

5. Pagesa për shërbim që do ta paguajë Komuna e Vushtrrisë për "Unitetin" do të bëhet në bazë të numrit të konsumatorëve të shërbimit.

6. Çmimi dhe numri i konsumatorëve të shërbimit janë të përcaktuar në **shtojcën C** të kësaj kontrate dhe mund të ndryshojë varësisht nga përditësimi i të dhënave.

7. "Uniteti" bën faturimin e bizneseve dhe arkëtimin e mjeteve të bizneseve në bazë të Rregullores Komunale për Menaxhimin e Mbeturinave 01.nr.189/15 dt.29.09.2015.

8. Komuna të përgatisë dhe informojë qytetarët në lidhje me procedurat e reja të pagesës, dhe t'i dorëzojë ato së bashku me faturat e para gjatë muajit korrik 2018.

9. Uniteti i përgatit faturat për klientët e shërbyer – bizneset për shërbimet e menaxhimit të mbeturinave, në përputhje me politikën tarifore të përcaktuar me Rregulloren për Menaxhimin e Mbeturinave 01.nr.189/15 dt.29.09.2015, të aprovuar nga Kuvendi Komunal i Vushtrrisë.

10. Komuna e Vushtrrisë nuk është përgjegjëse për mbledhjen e borxhit para nënshkrimit të kësaj kontrate, ato mbeten në përgjegjësi të "Unitetit".

11. "Uniteti" do t'i dorëzojë Komunës së Vushtrrisë faturën për shërbimin e kryer më së largu deri më datë 5 të muajit pasues.

12. Komuna e Vushtrrisë do të bëjë pagesën e shërbimit për "Unitetin", deri më datë 15 të muajit pasues. Nëse data 15 korrespondon me ditë pushimi, atëherë pagesa bëhet në ditën e parë pasuese të punës.

13.Nëse "Uniteti" vonon dorëzimin e faturës për shërbimin e kryer pas datës 5 të muajit pasues, atëherë pagesa e shërbimit do të shtyhet për aq ditë sa është vonuar dorëzimi i faturës.

14."Uniteti" ia ofron komunës një regjistër të azhurnuar të faturave që janë lëshuar dhe pagesave që janë pranuar, të ndara sipas llojeve të shërbimit (duhet të jetë fjala për bizneset e mesme dhe të mëdha).

### **Neni 15**

#### **Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

1.Kontestet që ndërlidhen me shërbimin e ofruar dhe të paguar në kuadër të kësaj KSH-je zgjidhen në radhë të parë, gjatë takimeve kontaktuese operative të rregullta. Çdo çështje që ka të bëjë me shërbimet e ofruara apo standardet e përshkruara në këtë KSH dhe që mbetet e pazgjidhur pasi të jetë trajtuar fillimisht duhet të shkallëzohet si vijon:

**1.1.Niveli i parë:** Nëse çështja mbetet e pazgjidhur, ankesa/t duhet t'i parashtrihen me shkrim bordit të drejtorëve/"Unitetit" përkatës, anëtarët e të cilit do ta shqyrtojnë çështjen brenda 5 ditëve të punës. Nëse çështja është e ndërlikuar dhe nuk është e mundur që të zgjidhet plotësisht brenda këtij afati kohor, atëherë një përgjigje e përkohshme me shkrim do të jepet brenda 5 ditëve të punës dhe çështja do të zgjidhet përfundimisht brenda 10 ditëve të punës.

**1.2.Niveli i dytë:** Pas nivelit të parë të zgjidhjes së kontestit, nëse çështja nuk është zgjidhur ende, atëherë ankesa/t, së bashku me dëshmitë përkatëse, duhet t'i përcillen me shkrim Komisionit komunal të aksionarëve përkatës. Ankuesit do t'i jepet një shqyrtim përfundimtar dhe një përgjigje me shkrim brenda 10 ditëve të punës.

**1.3.Niveli i tretë:** Nëse asnjë zgjidhje nuk mund të arrihet midis "Unitetit" dhe komunës, duhet të merret në konsideratë arbitrazhi i jashtëm (Gjykata Themelore në Mitrovicë – Dega në Vushtri ), ndërsa për çdo shpenzim përkatës do të vendosë gjykata.

2.Derisa të merret vendim e të qartësohet mosmarrëveshja apo pakënaqësia, "Uniteti" do të vazhdojë të ofrojë shërbimet në bazë të kësaj kontrate.

### **Neni 16**

#### **Ndëshkimet në rast të mospërbushjes së kontratës**

1.Në rast se shërbimi i kontraktuar nuk plotëson nivelin e cilësisë së parashikuar në kontratë, atëherë Komuna e Vushtrrisë do t'i zbrisë 5% të faturës së shërbimit.

2.Nëse e njëjta përsëritet në muajin pasues, atëherë do të aplikohet dyfishimi i ndëshkimit që do të thotë se ndëshkimi do të jetë 10% zbritje nga pagesa e faturës së shërbimit.

3.Gjatë cilësdos fazë të zgjidhjes së pakënaqësisë apo kontestit, shërbimet që ende nuk janë ofruar në shkallën e dakorduar të standardit të përcaktuar në kuadër të këtij dokumenti, mund të jenë shkas për një ndëshkim financiar që duhet të përcaktohet pas procesit të monitorimit nga komuna.

4.Derisa të merret vendim e të qartësohet mosmarrëveshja apo pakënaqësia, "Uniteti" do të vazhdojë të ofrojë shërbimet në bazë të kësaj kontrate.

### **Neni 17** **Rishikimi i kontratës**

1.Kjo kontratë dhe të gjitha pjesët përbërëse të saj do të rishikohen sipas nevojës dhe me kërkesë të Komunës së Vushtrrisë.

2.Rishikimi do të përqendrohet në cilësinë e shërbimit të ofruar, duke përfshirë zgjerimin e planifikuar, duke punuar së bashku për ta përmirësuar shërbimin sipas PIO-së së ndërmarrjes “Uniteti”, mundësinë e zhvillimit të procedurave të prokurimit në kuadër të strategjisë për efikasitet.

3.Për çdo ndryshim/ndërrim në shërbimet e ofruara që do të ndikojë gjatë implementimit të kësaj kontrate duhet të dakordohet nga të dyja palët.

### **Neni 18** **Anulimi**

1.Kjo kontratë mund të anulohet me pajtimin e të dyja palëve me shkrim ose nëse cilado palë jep njoftim me shkrim për anulimin e kontratës, katër (4) muaj para se të anulohet.

2.Nëse “Uniteti” nuk i ofron shërbimet e dakorduara në përputhje me standardet e shërbimit që janë përcaktuar në këtë kontratë gjatë një periudhe të vazhdueshme prej 3 muajsh, kjo kontratë do të anulohet automatikisht dhe komuna nuk do të jetë e obliguar ta paguajë asnjë faturë të dorëzuar për shërbimet e ofruara gjatë kësaj periudhe.

3.Kjo kontratë anulohet në momentin që komuna vendos të ndryshojë apo të reformojë fushën për menaxhimin e mbeturinave komunale në Komunën e Vushtrrisë, e përcaktuar sipas Ligjit Nr. 04/L-060 për Mbeturina, si dhe Rregullores Komunale për Menaxhimin e Mbeturinave 01.nr.189/15, datë 29.09.2015.

### **Neni 19** **Nënshkrimi i kontratës**

1.Kjo kontratë nënshkruhet në katër (4) kopje orgjinale , nga dy (2) kopje për secilën palë në këtë marrëveshje.

2.Pjesë përbërëse e kësaj kontrate janë shtojcat A, B dhe C.

**Neni 20**  
**Hyrja në fuqi**

1.Kjo kontratë hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga ana e palëve kontraktuese.

2.Me hyrjen në fuqi të kësaj kontrate (marrëveshjeje), shfuqizohet Marrëveshja Nr.1223/16, dt. 28.12.2016, Marrëveshja për Shërbimet primare të menaxhimit të mbeturinave në territorin e Komunës së Vushtrrisë.



**Kryetar i Komunës së Vushtrrisë**

**Xhafer Tahiri**

**Drejtor i KRM "Uniteti" Njësia në Vushtri**

**Tahir Krasniqi**

## Shtojca A–Standardet e detajuara të shërbimit

1. Shërbim i mbledhjes, largimit dhe transportimit të mbeturinave konsiston në:
  - a. zbrazen e kontejnerëve me një pajisje teknologjike të përshtatshme (p.sh. kamion për ngjeshje). Ngritja mekanike e kontejnerëve kërkohet veçanërisht në rast të kontejnerëve të komunitetit;
  - b. mbledhjen dhe largimin e mbeturinave të hedhura në një rreze prej 10 metrave (mbeturina të amvisërisë) përreth lokacionit të kontejnerëve, dhe fshirjen e një hapësire përreth lokacionit me fshesë të dorës, si dhe zëvendësimin e kontejnerëve të riparuar në lokacionin e duhur. Kontejnerët duhet të vendosen në mënyrë estetike dhe të drejtë, në një pozitë vertikale dhe të kenë rrota funksionale (sipas mundësisë). Edhe shportat dhe thasët e vegjël të amvisërive duhet të mblidhen siç është përcaktuar në PIO;
  - c. shërbimet përfshijnë edhe dezinfektimin e kontejnerëve të mbeturinave (posaçërisht kontejnerëve të komunitetit) së paku një herë në muaj me pluhur gëlqereje që përmban 5% klor apo element tjetër ekuivalent brenda secilit kontejner. Ky dezinfektim duhet të bëhet pasi të largohen mbeturinat nga kontejneri dhe në vende të veçanta.
2. Komuna bashkërendohet me “Unitetin” për t’i përcaktuar lokacionet e sakta të kontejnerëve dhe numrin e kontejnerëve për secilën pikë në tërë zonën e shërbimit, duke i përfshirë të gjitha pikat e grumbullimit afër tregjeve që gjenden në zonën e shërbimit.
3. “Uniteti” e realizon Planin e Itinerarit dhe Operativ (PIO-në, i cili u bashkëngjitet specifikacioneve teknike) dhe çdo ndryshim gjatë afatit të zbatimit të kësaj KSH-je. Ky plan mund të ndryshohet me propozimin e “Unitetit” dhe në pajtim me komunën, sipas nevojave për përmirësim të shërbimit dhe menaxhim më të mirë, apo si rezultat i ndryshimeve në infrastrukturë. Në çdo rast, ndryshimet bëhen me kërkesën e njërës palë dhe me aprovimin e komunës.
4. Oraret mujore të punës për shërbime i përgatit “Uniteti” dhe i aprovon komuna. Këto orare mund t’u nënshtrohen ndryshimeve sa herë që ka nevojë. Në planin e punës specifikohet saktësisht:
  - a. Orari i punës (plani kohor) për çdo lokacion të kontejnerëve;
  - b. lloji, numri i tabelave dhe itinerari i automjeteve për mbledhjen e mbeturinave që do të përdoren për këtë shërbim;
  - c. orari i punës (plani kohor) dhe automjetet për mbështetjen e shërbimeve;
  - d. numri i punëtorëve që do angazhohen në çdo operacion pune.
5. “Uniteti” i zbaton oraret e punës me rigorozitet.
6. Për oraret e largimit të mbeturinave që do të dorëzohen për aprovim do të merret parasysh se punët do të kryhen duke u bazuar në PIO.
7. Komuna ka të drejtë t’i inspektojë lokacionet e kontejnerëve në çdo kohë dhe pas shërbimit ta kontrollojë performancën për shërbimet e lartpërmendura, zbatimin e standardeve të kërkuara, rregullave dhe cilësisë së kërkuar në këtë kontratë dhe të vendosë për zbatimin e ndonjë zbritjeje, ndëshkimi apo gjobe për punën e pakryer.

8. Lokacionet e kontejnerëve duhet të jenë të pastra, prandaj, "Uniteti" duhet të kërkojë nga punëtorët që t'i mirëmbajnë dhe të pastrojnë këto lokacione.
9. Në asnjë rast, kontejnerët e stërmbushur nuk do të lihen në gjendje të tillë, e të mos zbrazen për një periudhë prej më shumë se një ditë. Në rast se faktorë zbutës janë pengesat që shkaktohen nga faktorët madhorë, "Uniteti" e bën të ditur këtë menjëherë dhe merr masa për mbledhjen e mbeturinave jo më vonë se 3 orë pas kohës së shërbimit të planifikuar, të saktësuar në PIO. Përndryshe, "Uniteti" konsiderohet përgjegjëse dhe mund të shqiptohen ndëshkime.
10. Nga "Uniteti" mund të kërkohej që t'i mbledhë dhe transportojë mbeturinat komunale që hidhen në hapësirat publike brenda zonës së kontraktuar, (p.sh. kur prodhuesi i mbeturinave i hedh ato larg vendeve të aprovuara për deponim). Në rast se mbeturinat hidhen vazhdimisht në vende të tjera, ofruesi i shërbimit e rishikon PIO-në dhe kërkon aprovim për vendosjen e kontejnerëve shtesë.
11. "Uniteti" e informon komunën periodikisht me shkrim për të gjitha kontratat private për pastrim që i ka me palët e treta dhe e deklaron numrin e automjeteve dhe punëtorëve shtesë për këto shërbime për ta garantuar cilësinë e shërbimit të kërkuar sipas kësaj KSH-je.
12. "Uniteti" do ta ketë një linjë telefonike funksionale pa pagesë sipas nenit 12, pikës 1.9 të përcaktuar si më lart dhe duhet të ofrojë zgjidhje për çështjet e ngritura brenda 24 orëve.
13. Nga "Uniteti" kërkohej që ta sigurojë disponueshmërinë e numrit të kërkuar të automjeteve dhe pajisjeve.
14. Nga "Uniteti" kërkohej që ta sigurojë disponueshmërinë e numrit të kërkuar të punëtorëve dhe vozitësve siç është përcaktuar në PIO.
15. Nëse gjatë transportimit mbeturinat bien nga automjetet për mbledhjen e mbeturinave, brenda apo jashtë zonës së shërbimit, materialet e derdhura pastrohen menjëherë. Përndryshe, përveç mbulimit të shpenzimeve për mbledhjen dhe largimin e mbeturinave të përhapura, "Uniteti" mund t'u nënshtrohet ndëshkimeve apo gjobave sipas ligjeve dhe vendimeve në fuqi për ndotjen e shkakuar.
16. Staf i operativ i "Unitetit" mban veshur uniforma përderisa është në detyrë dhe i përdor pajisjet e nevojshme mbrojtëse personale, siç janë dorëzat, këpucët e qëndrueshme me shputë të fortë dhe xhaketat fluoreshente.

17. Kontejnerët vendosen sipas PIO-së. "Uniteti" mund ta rrisë numrin e kontejnerëve nëse ka nevojë sipas kërkesave dhe vëllimeve të mbeturinave të ngurta komunale që prezantohen për mbledhje pas marrjes së pëlqimit nga komuna.
18. Uniteti ka obligim që gjatë gjithë kohëzgjatjes së kësaj kontrate të shpërndajë faturat më parë të shtypura dhe të zarfuara nga komuna. Përveç faturave "Uniteti" do të dërgojë edhe fletushka të tjera të nevojshme për informim të qytetarëve.
19. Largimi i mbeturinave të vëllimshme bëhet nga pikat afër kontejnerëve dhe duhet të bëhet në mënyrë permanente. Në rastet kur ato janë të hedhura larg pikave të kontejnerëve, ato duhet të largohen maksimalisht një ditë pas pranimit të informatës.
20. Në pajtim me Komunën e Vushtrrisë, "Uniteti" obligohet të hartojë një plan për mbledhjen e mbeturinave të vëllimshme. Në këtë plan do të caktohen ditët të cilat do të mblidhen mbeturinat e vëllimshme nga qytetarët derë më derë. Mbledhja e këtyre mbeturinave do të bëhet minimum çdo dy (2) muaj për secilën lagje.
21. Largimi i mbeturinave nga konstruksioni, kurse emolomi bëhet nga pikat afër kontejnerëve në mënyrë permanente. Në rastet kur ato janë të hedhura larg pikave të kontejnerëve ato duhet të largohen maksimalisht një ditë pas pranimit të informatës.
22. Kontratat me mishtore duhet të zbatohen në përpikëri. Mbeturinat nga këto biznese duhet të trajtohen në mënyrë të veçantë duke iu ofruar edhe kontejnerë të posaçëm dhe duke shfrytëzuar makineri të veçantë për mbledhjen e tyre.
23. Automjetet teknologjike të nevojshme për mbledhjen dhe transportimin e mbeturinave dhe për shërbimet mbështetëse që kërkohen për përmbushjen e kontratës janë:
  - a. Automjetet teknologjike për transportim me ngarkim të pasmë, anësor dhe të përparmë përmbledhjen dhe transportimin e mbeturinave me kapacitet adekuat dhe dokumentacion të rregullt për përdorim për ta siguruar përdorimin efikas;
  - b. Kamionët të hapur me dokumentacion të rregullt për përdorim, të cilët mund të përdoren për mbledhjen e mbeturinave në lagjet e qytetit apo në fshatra duke përdorur thasë;
  - c. Të gjitha automjetet teknologjike përdoren sipas të dhënave teknike dhe specifike të automjetit.
24. Komuna mund t'i inspektojë automjetet që i përdor "Uniteti" në çdo kohë për ta vlerësuar gjendjen operative dhe disponueshmërinë e tyre.
25. Të gjitha automjetet që do të përdoren për shërbime duhet të jenë operacionale, të pastra dhe në rregull, të ngjyrosura me të njëjtën ngjyrë dhe ta bartin logon apo shenjën e identifikimit të komunës dhe/ose "Unitetit".

26. Automjetet për mbledhjen e mbeturinave duhet të pastrohen dhe të dezinfektohen rregullisht sipas kontratës të arritur me komunën (p.sh. çdo javë).
27. Të gjithë kontejnerët e përdorur duhet të mbahen të pastër dhe në gjendje teknike të mirë. Në rast të dëmtimit, djegies, deformimit dhe dëmtimit të rrotave dhe kapakëve që e pengon përdorimin higjienik, estetik dhe teknik gjatë kohëzgjatjes së kontratës, si dhe në rast të mungesës së kontejnerëve, ofruesi i shërbimit e mbanë përgjegjësinë për mbrojtjen, mirëmbajtjen dhe riparimin e kontejnerëve në çdo rast apo për çfarëdo arsye. “Uniteti” e ndërmerri riparimin e të gjitha dëmeve dhe sigurimin e pjesëve rezervë brenda 3 ditëve nga momenti kur vërehet dëmtimi.
28. “Uniteti” e përdor emrin e saj në korrespondencat e përbashkëta, thirrjet telefonike, shenjat e automjeteve dhe emrin e regjistrimit. Për korrespondenca zyrtare përdoret adresa e postës elektronike zyrtare të “Unitetit”.

## Shtojca B – Lokacionet e caktuara

Për këtë KSH do të vlejnjë lokacionet e caktuara në vijim:

- Qyteti i Vushtrrisë, dhe
- Në të gjitha fshatrat.

Nr.	Vendbanimi	Vendbanimi
1.	Akrashticë	36. Novolan
2.	Balincë	37. Oshlan
3.	Banjskë	38. Pantinë
4.	Beçiq	39. Pasomë
5.	Beçuk	40. Pestovë
6.	Begaj	41. Prelluzhë
7.	Bivolak	42. Reznik
8.	Boshlan	43. Ropicë
9.	Brusnik	44. Samadrexhë
10.	Bukosh	45. Sfarçak i Epërm
11.	Ceceli	46. Sfarçak i Poshtëm
12.	Dalak	47. Shalë
13.	Dobërllukë	48. Shlivovicë
14.	Druar	49. Shtitaricë
15.	Duboc	50. Skoçan
16.	Dumnicë e Epërme	51. Skromë
17.	Dumnicë e Llugës	52. Sllakoc
18.	Dumnicë e Poshtme	53. Sllatinë
19.	Galicë	54. Smrekonicë
20.	Gllavatin	55. Stanoc i Epërm
21.	Gojbulë	56. Stanoc i Poshtëm
22.	Gracë	57. Stroc
23.	Gumnishtë	58. Studime e Epërme
24.	Hercegovë	59. Studime e Poshtme
25.	Karaçë	60. Taraxhë
26.	Kollë	61. Tërllobuq
27.	Kunovik	62. Vërmicë
28.	Kurillovë	63. Vesekoc
29.	Jezerë – Liqej	64. Vilanc
30.	Lun adh	65. Vushtrri
31.	Mavriq	66. Zagorë
32.	Maxhunaj	67. Zhilivodë
33.	Mihaliq	
34.	Miraçë	
35.	Nedakoc	

### Shtojca C

### Pjesa II. LISTA E ÇMIMEVE

#### Paramasa

Emërtimi	Njësia	Sasia A	Çmimi njësi për muaj- € B	Totali për muaj € C= A x B	Çmimi i shumëzuar për 6 muaj D	Totali për 6 muaj E= C x D
Familjet e shërbyera	Nr. Amvisërisë	17400	3.0			
Familjet nga diaspora	Nr. i konsumatorëve					